




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Duke u bazuar në Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna për shpalljen në konsultim publik të Projekt Planit të Punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 Zyra për Informim në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Rahovecit lëshon këtë:



NJOFTIM PUBLIK

LIDHUR ME KONSULTIMIN PUBLIK PËR PROJEKT PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

Draft-Projekt Planin e Punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 do të jetë në shqyrtim publik nga **15/10/2021** deri me datën: **15/11/2021**.

Konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **11/11/2021**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora **10:00**.

Duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/41 të datës 23.10.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollimin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, përkatësisht nenit 25 numri i pjesëmarrësve të lejuar në ambiente të mbyllura duhet të jetë deri në 30 persona. Pjesëmarrësit duhet të kenë njërin nga dëshmitë e cekura si më poshtë:

- Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë (me dy doza) kundër COVID-19;
- Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
- Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (testi RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultati pozitiv i testit të antitropave serologjik-IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
- Testi i shpejtë negativ jo më i vjetër se 48 orë.

Të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo komentet mund ti dërgoni edhe përmes formës elektronike në këto E-maila: Haziz.Krasniqi@rks-gov.net , Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Blerta.Gashi@rks-gov.net.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij projekti, Komuna e Rahovecit, përkatësisht Zyra për Informim, ka publikuar këtë dokument në ueb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit, në rubrikën “Konsultime Publike” në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>, dokumenti është publikuar në Platformën e Konsultimeve Publike: <http://konsultimet.rks-gov.net/>.

Haziz Krasniqi

Zyrtar për Informim

